

INSTRUKSIONE PËR ABSTRAKTET

Informacione të përgjithshme

- Abstraktet do të konsiderohen për prezantim oral, komunikim i shkurtër ose poster.
- Të gjithë abstraktet duhet të ngarkohen nëpërmjet linkut:
https://docs.google.com/forms/d/1e1GLpkMPBEJ6iNTtdAyNTCDzM_H1MsIKLSg2hGGC0/edit
- Afati i dorëzimit të abstrakteve: 21 Mars 2025
- Aplikantët do të njoftohen mbi pranimin e abstraktit/ abstrakteve në 15 Prill 2025.
- Konferenca do të akreditohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (ASCK)
- Individët duhet të regjistrohen në konferencë për të prezantuar punimin e dërguar në abstrakt.

Instruksione mbi hartimin e abstraktit

Abstrakti këshillohet të strukturohet si mëposhtë:

Titulli: Titulli duhet të jetë i shkurtër, pa shkurtime dhe iniciale.

Autoret: Rendisni autorët (emra mbiemra të plotë) dhe institucionet e tyre sipas radhës së dëshiruar.

Institucionet: Nëse autorët i perkasin më shumë se një institucioni, ju lutemi përdorni 1, 2, 3 për t'i listuar ato dhe vendosni numrin përkatës në krah të autorit.

Kontakti: Vendosni adresën e email-it të autorit referues.

Abstrakti: Abstrakti duhet të jetë maksimumi 250 fjalë pa përfshirë titullin, emrat e autorëve dhe institucionet.

- **Abstraktet e punimeve origjinale** duhet të strukturohen në mënyrë objektive dhe të përmbledhur, duke përfshirë informacionin thelbësor sipas këtyre seksioneve:

- **Hyrje:** autorët duhet të paraqesin shkurtimisht informacionet e njohura në literaturë mbi temën dhe të përshkruajnë cilat janë arsyet kryesore që kanë çuar në zhvillimin e studimit.
- **Objektivat:** autorët duhet të specifikojnë qartë qëllimet kryesore të studimit. Objektivat duhet të jenë të sakta, të matshme dhe të përcaktohen në mënyrë të qartë.
- **Metodat:** duhet të përshkruhen metodat e përdorura për të realizuar kërkimin. Kjo mund të përfshijë informacion mbi dizajnin e studimit, mjetet dhe teknikat e përdorura për mbledhjen e të dhënave, si dhe strategjitë për analizën e tyre. Këto të dhëna duhet të jenë të mjaftueshme për të mundësuar riprodhimin e studimit nga studiues të tjerë.
- **Rezultatet:** autorët duhet të paraqesin rezultatet e studimit në mënyrë të qartë duke përfshirë të dhëna kuantitative dhe/ose cilësore që mbështesin objektivat e studimit. Rezultatet duhet të jenë të sakta, të përmbledhura dhe të shoqëruara me analiza statistikore.
- **Përfundimi:** autorët duhet të përmbledhin gjetjet kryesore të studimit dhe të ilustronë kontributin e tyre në njohuritë ekzistuese. Përfundimi mund të përfshijë gjithashtu kufizimet e studimit dhe sugjerime për kërkime të mëtejshme.

- **Abstraktet e rasteve klinike** duhet të strukturohen si më poshtë:

- **Hyrja:** Në këtë pjesë, autorët duhet të prezantojnë shkurtimisht rëndësinë e rastit klinik dhe kontekstin mjekësor të tij. Duhet të përshkruhet se pse ky rast është interesant ose i veçantë dhe si lidhet me literaturën ekzistuese.
- **Paraqitja e Rastit:** duhet të përshkruhen detajet e rastit konkret: historia mjekësore e pacientit, simptoma, gjetjet klinike, rezultatet e testeve dhe çdo procedurë diagnostikuese ose terapeutike që është përdorur. Kjo pjesë duhet të jetë e qartë dhe të japë informacion të detajuar për të ndihmuar lexuesin të kuptojë kompleksitetin e rastit.
- **Diskutimi:** autorët duhet të analizojnë dhe interpretojnë rastin duke bërë lidhjen me literaturën ekzistuese ku shqyrtohen mundësitë diagnostikuese, trajtimet dhe menaxhimi i ngjashëm me raste të tjera. Diskutimi duhet të analizojë gjithashtu vecantinë e këtij rasti nga protokollet e zakonshme.
- **Komentet dhe përfundimet:** autorët duhet të paraqesin përfundimet kryesore të rastit dhe të theksojnë mësimet që mund të nxirren për praktikën mjekësore, duke ofruar

rekomandime të vlefshme për përmirësimin e procesit të diagnozës dhe trajtimit në të ardhmen.

Bibliografia: Për çdo abstrakt duhet të përfshihen referencat bibliografike të viteve të fundit.

Stili i tekstit: Abstraktet duhet të shkruhen në Times New Roman, madhësia e shkronjave 12, me hapësirë njëshe.

Formati: Abstrakti duhet të dërgohet në formatin Microsoft Word ose në PDF.

Procedura

e

Vlerësimi

Të gjitha abstraktet do të rishikohen nga Komiteti Shkencor sipas kriterëve të mëposhtme:

- (i) rishikimi dhe rendësia e punës kërkimore;
- (ii) metodologjia;
- (iii) implikimet për kërkimin dhe praktikën mjekësore